



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KESHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr.2530, datë 23.12.2014

Për

“Miratimin e dokumentit “Rregullore për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 23.12.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e dokumentit “Rregullore për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative”

B A Z A L I G J O R E:

1. Shkronjat a), l) dhe p) të nenit 8, neni 110, 114, 115, 132, 133 e vijues të ligjit Nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918, i ndryshuar*);
2. Ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*);
3. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2509, datë 30.10.2014 për “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Rregullore për

Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative””;

4. Udhëzuesi “Për procedurat e Këshillimit Publik”, miratuar me Vendim nr.1183, datë 10.03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP;
5. Urdhri nr. 1254, datë 04.07.2014, për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektaktit “Rregullore për *“Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative ”*”,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të grupit të punës si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues mbi Projekt-vendimin për miratimin e dokumentit *“Rregullore për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative”*,
2. Publikimi i qendrimit të AKEP mbi komentet dhe sygjerimet e palës së interesuar mbi dokumentin për Këshillim Publik *“Rregullore për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative”*;
3. Projekt akti i paraqitur për miratim: *“Rregullore për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative”*;
4. Projekt-Vendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar,
5. si dhe, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke i'u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP nëpërmjet Vendimit Nr.2509, datë 30.10.2014, si dhe në zbatim të nenit 110, të ligjit nr. 9918, i ndryshuar publikoi dokumentin *“Rregullore për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative”* në faqen e internetit: www.akep.al dhe ishte në pritje të komenteve nga palët e interesuara, periudha e caktuar për Këshillimin Publik, filloi më datë 30.10.2014 deri më datë 29.11.2014;
2. Grupi i punës pas përfundimit të afateve të këshillimit publik, ka marrë në shqyrtim komentet e palëve të interesuar mbi projekt aktin administrativ *Rregullore “Për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative”* si më poshtë vijon:
 - Sipërmarrësi Albtelecom Sh.a dërguar me shkresën nr. 11313 prot, date 9.12.2014 prot i AKEP (nr. 2250/4, datë 10.12.2014).
 - Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a dërguar me shkresën nr. LRD/0240/IK datë 02.12.2014 prot i AKEP (nr.1686, prot, date 03.12.2014);

3. Dokumenti Rregullorë “Rregullorë për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor përkatës;
4. Hartimi i dokumentit është bazuar në mbështetje të shkronjës a), l) dhe p) të nenit 8, neni 110, 114, 115, 132, 133 e vijues të ligjit Nr. 9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar;
5. AKEP, me qëllim ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve në përputhje me parimin e ligjmërisë, në kuadër të inspektimit dhe monitorimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike, pasi ka marrë në konsideratë edhe propozimet e pales së interesuar, çmon si të rëndësishme miratimin e Rregullores “Për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative”;

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e nxjerrjes së këtij dokumenti, si për AKEP ashtu dhe për sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike dhe postare, bazuar në gërmën p) të nenit 8, neni 110, 114, 115, 132 dhe 133 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, indryshuar,

V E N D O S :

1. Të miratojë dokumentin “Rregullorë për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Të miratojë dhe publikojë përfundimin e këshillimit publik mbi dokumentin “Rregullorë për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative” ;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Alketa MUKAVELATI** _____
3. **Benon PALOKA** _____
4. **Zamira NURÇE** _____

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

- 1.1 Qëllimi i Rregullores është kryerja e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike dhe postare ose çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, monitorimi i spektrit të frekuencave dhe vendosja e sanksioneve në rastet e vërtetimit të kundërvajtjeve administrative, në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore dhe nënligjore, kompetencat e AKEP dhe parimet e së drejtës.

Neni 2

Objekti

- 2.1 Objekti i rregullores është përcaktimi i procedurave të inspektimeve që kryen AKEP në zbatim të detyrimeve dhe ushtrimit të kompetencave ligjore, gjatë kontrollit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (*sipërmarrësve*) dhe postare, si dhe çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike (*subjekti*) sipas ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , akteve nënligjore, si dhe akteve administrative të nxjerra nga AKEP, në zbatim të këtij ligji.
- 2.2 Objekti i rregullores është përcaktimi i procedurave të monitorimit të spektrit të frekuencave me qëllim që spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar, sipas dispozitave të ligjit 9918, i ndryshuar dhe krijimi i një mjedis të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit radio, që do të përdoren për qëllime private ose publike.
- 2.3 Objekt i rregullores është dhe përcaktimi i rregullave për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative nëpërmjet inspektimit, monitorimit të spektrit të frekuencave dhe veprimin “kryesisht” të AKEP, përcaktimi i procedurave dhe i afateve të ankimit ndaj akteve të monitorimi-inspektimit të AKEP që vendosin masa administrative, si dhe i procedurave të ekzekutimit të sanksioneve administrative.

Neni 3

Baza Ligjore

Rregullimet e përcaktuara në këtë rregullore mbështeten ligjërisht në:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RR E G U L L O R E

Nr. 34, datë 23.12.2014

PER

**“INSPEKTIMIN, MONITORIMIN E SPEKTRIT TE
FREKUENCAVE DHE MASAT ADMINISTRATIVE”**

Tiranë, 2014

- 3.1 Shkronjat a), f) dhe l) të nenit 8, nenin 132, 133 e vijues të ligjit Nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918, i ndryshuar*);
- 3.2 Ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*);
- 3.3 Ligjin Nr.10 279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” (*ligji nr. 10 279*);
- 3.4 Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (*ligji nr. 9367, i ndryshuar*);
- 3.5 Ligji Nr.8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Neni 4

Konflikti i interesave

Në zbatim të kësaj rregulloreje konflikt interesash midis inspektorit dhe sipërmarrësve dhe/ose subjektit, përbëjnë rastet kur:

- 4.1 Inspektori, ka qenë punonjës pranë sipërmarrësit/subjektit deri 3(tre) vitet e fundit përpara punësimit në AKEP;
- 4.2 Në çdo rast tjetër që paraqiten prova të besueshme që vërtetojnë një konflikt interesash sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr.9367, i ndryshuar;

KREU II

INSPEKTIMI

Neni 5

- 5.1 Inspektimi i veprimtarisë së sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike dhe postare ose çdo personi tjetër fizik apo juridik, që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, kryhet nga inspektorët e AKEP-it, mbi bazën e një Urdhëri Inspektimi të nxjerrë nga Kryetari i Këshillit Drejtues të AKEP (Kryetari), sipas procedurës së përcaktuar në këtë rregullore dhe në 2 (dy) forma:

- A) **Inspektimi ne distance:** Inspektimi i veprimtarisë së sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike dhe postare ose çdo personi tjetër fizik apo juridik, që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, kryhet ne distance (shih neni 31).
- B) **Inspektim ne terren:** Inspektimi i veprimtarisë së sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike dhe postare ose çdo personi tjetër fizik apo juridik, që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, kryhet në mjediset, ku sipërmarrësi zhvillon veprimtarinë.

- 5.2 Inspektorët e AKEP-it pajisen me dokument të posaçëm identifikimi. Ata kryejnë inspektim në mjediset, ku sipërmarrësi zhvillon veprimtarinë edhe pa e njoftuar paraprakisht, për të verifikuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave përkatëse, të nxjerra në zbatim të tij.
- 5.3 Cdo punonjës i AKEP (drejtor drejtorie/përgjegjës sektori dhe specialist) ushtron sipas rastit edhe detyren e inspektorit. Kryetari në Urdhërin e Inspektimit përcakton përbërjen e grupit të inspektimit.
- 5.4 Sipërmarrësi ose çdo person tjetër, fizik apo juridik, që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, është i detyruar t'i lejojë inspektorët të kryejnë inspektimin kudo ku ka pajisje të komunikimeve elektronike, si dhe t'i ofrojnë inspektorëve të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar prej tyre.

Neni 6 Caktimi i inspektorëve

Inspektorët në përbërje të grupit të inspektimit caktohen në varësi të tematikës së inspektimit, sipas propozimit të drejtorisë të paraqitur në Projekt-Urdhërin e Inspektimit dhe Monitorimit.

Neni 7 Dokumenti i posaçëm identifikues

Inspektorët, pajisen nga AKEP me dokument identifikimi të posaçëm i cili përmban, emrin dhe mbiemrin e inspektorit, fotografinë e tij, pozicionin e punes, datën e lëshimit, nënshkrimin e Kryetarit në detyrë dhe vulën e institucionit.

Neni 8 Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e inspektorit

- 8.1 Inspektori, gjatë ushtrimit të detyrës gëzon të drejtën e mbrojtjes së jetës dhe çdo mbrojtje tjetër të parashikuar ligjërisht në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 8.2 Në përputhje me marrëveshjet e lidhura midis AKEP me organet e ruajtjes së rendit, organet tatimore dhe pushtetit vendor, inspektori ka të drejtë të kërkojë në rast nevojë, mbështetjen e strukturave të tyre.
- 8.3 Inspektori në përbërje të grupit të inspektimit, ka të drejtë të kërkojë mosmarrjen pjesë në inspektim nëse vërteton sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, se ndodhet në konditat e konfliktit të interesit me sipërmarrësin/subjektin që do të inspektohet.
- 8.4 Inspektori në kryerjen e inspektimit është i detyruar të zbatojë rigorozisht Urdhërin e Inspektimit duke vepruar në përputhje me parimet e parashikuara në ligjin nr. 8485.

- 8.5 Inspektori në rastet e vendosjes së masave administrative duhet të zbatojë vetëm përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 9918 i ndryshuar dhe procedurën sipas ligjit.
- 8.6 Inspektori është përgjegjës administrativisht dhe ligjërishit për moskryerje të detyrës ose për veprimet e dëmshme dhe antiligjore kundrejt sipërmarrësve/subjekteve.
- 8.7 Këshilli Drejtues i AKEP, në rast se vërteton shkelje të kryera nga ana inspektori gjatë ushtrimit të detyrës të cilat nuk përbëjnë vepra penale, në varësi të shkeljes së kryer vendos masë disiplinore sipas parashikimeve të përcaktuara në aktet normative në fuqi.

Neni 9 Veprimet e autorizuara

Inspektorët gjatë kryerjes së inspektimit janë të autorizuar:

- 9.1 Të kryejnë, në bazë të Urdhërit të Inspektimit dhe Monitorimit, veprimet e nevojshme për realizimin e detyrave të ngarkuara, në çdo kohë dhe në të gjitha ambjentet dhe zonën gjeografike ku shtrihet veprimtaria e sipërmarrësit/subjektit që inspektohet.
- 9.2 Të kërkojnë zbatimin e masave rregullatore, ligjeve dhe procedurave të tjera për mënjanimin e të metave dhe shkeljeve të konstatuara.
- 9.3 Të bllokojnë pajisjet në rastet e përcaktuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 134 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar.
- 9.4 Të propozojnë masa administrative sipas pikës 2 të nenit 135 ose të vendosin gjoba sipas nenit 137 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar kur vërtetojnë se sipërmarrësi ka kryer shkelje të cilat përbëjnë kundravajtje administrative.

Neni 10

Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e sipërmarrësve/subjekteve

- 10.1 Sipërmarrësit/subjektet janë të detyruar që në zbatim të ligjit nr.9918 i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi, të mos pengojnë ushtrimin e inspektimit të veprimtarisë së tyre nga inspektorët e AKEP-it.
- 10.2 Sipërmarrësit/subjektet janë të detyruar t'i japin grupit të inspektimit të AKEP, informacionin e kërkuar, të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm sipas tematikës së përcaktuar në Urdhërin e Inspektimit.
- 10.3 Sipërmarrësit/subjektet, janë të detyruar të lejojnë inspektorët në përbërje të grupit të inspektimit, që sipas Urdhërit të Inspektimit të kryejnë inspektimin e të gjitha pajisjeve të instaluar në rrjet dhe/ose që shërbejnë për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe/ose postare.
- 10.4 Sipërmarrësit/subjektet që inspektohen nga AKEP, brenda 48 orëve nga kryerja e veprimit, kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë Këshillit Drejtues të AKEP, nëse inspektorët gjatë kryerjes së detyrës tejkalojnë ose abuzojnë

me kompetencat e parashikuara sipas kësaj rregulloreje, kryejnë veprime të kundraligjshme dhe të dënueshme ligjërisht. Ankimi duhet të shoqërohet me prova që vërtetojnë kryerjen nga inspektori të veprimit abuziv dhe në kundërshtim me ligjin.

- 10.5 Kundër gjobës së vendosur nga grupi i inspektimit ose në rastet “*kryesisht*”, sipërmarrësit/subjektet, kanë të drejtë të bëjnë ankim në Këshillin Drejtues të AKEP-it, brenda 10 ditëve nga data e dhënies së saj, si dhe në Gjykatën kompetente sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile dhe ligjin nr. 9918 i ndryshuar.
- 10.6 Sipërmarrësit/subjektet, ndaj të cilëve grupi i inspektimit propozojnë masa administrative sipas pikës 2 të nenit 135 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar, kanë të drejtë të thirren nga AKEP-i në seancë dëgjimore, për të dhënë shpjegimet e tyre përpara se Këshilli Drejtues i AKEP-it të marrë vendimin përkatës. AKEP-i merr vendim në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative.
- 10.7 Sipërmarrësi/subjekti, mban përgjegjësi administrative dhe ligjore nëse përpara, gjatë ose pas inspektimit kryen i vetëdijshëm dhe në mënyrë të qëllimshme veprime të kundraligjshme të cilat mund të pengojnë, fshehin ose shuajnë fakte të cilat vërtetojnë ushtrimin e veprimtarisë së subjektit në kundërshtim me ligjin nr. 9918, date 19.5.2008 i ndryshuar, aktet nënligjore dhe rregulloret në zbatim të tij.

Neni 11

Fazat e procedurës së inspektimit

Procedura e inspektimit kryhet në tre faza:

- 11.1 Faza përgatitore, e cila nënkupton njohjen e inspektorëve në përbërje të grupit të inspektimit sipas Urdhërit të Inspektimit, me tematikën, dokumentacionin dhe të dhënat që disponon AKEP-i mbi subjektin që do të inspektohet, aktet mbështetëse ligjore dhe nënligjore, si dhe përpilimin e planit të veprimit në zbatim të Urdhërit të Inspektimit.
- 11.2 Faza e zbatimit, e cila nënkupton paraqitjen tek sipërmarrësi dhe kryerjen e inspektimit në përputhje me tematikën e Urdhërit të Inspektimit dhe planin e veprimit në zbatim të tij.
- 11.3 Faza mbyllëse, e cila nënkupton përpilimin e aktit të inspektimit dhe caktimin e masave administrative/gjobave nëse do të ketë të tilla.

Neni 12

Procedura e inspektimit

- 12.1 Inspektimi kryhet duke e njoftuar paraprakisht sipërmarrësin/subjektin për tematikën dhe datën e inspektimit por, edhe pa e njoftuar atë nëse një

veprim i tillë kushtëzohet nga shkaqe ose rrethana të veçanta sipas tematikës dhe qëllimit të inspektimit.

- 12.2 Inspektorët në përbërje të grupit të inspektimit, përpara fillimit të inspektimit i paraqesin përfaqësuesit të autorizuar të sipërmarrësit/subjektit, Urdhërin e Inspektimit dhe dokumentat e tyre identifikues. Një kopje e Urdhërit të Inspektimit i dorëzohet sipërmarrësit.
- 12.3 Përfaqësuesi i autorizuar i sipërmarrësit/subjektit, u krijon inspektorëve të gjitha kushtet e nevojshme për realizimin e inspektimit sipas tematikës dhe qëllimit të tij dhe, i shoqëron ata personalisht ose duke caktuar njërin nga personeli i tij, gjatë gjithë kohës që inspektorët do të ndodhen në ambjentet e tij.
- 12.4 Inspektorët gjatë ushtrimit të inspektimit veprojnë për sa është e nevojshme të përmbushin detyrën në përputhje me tematikën e inspektimit. Por, nëse gjatë kontrollit konstatohen shkelje të tjera jashtë tematikës së inspektimit, atëherë grupi i inspektimit i propozon Kryetarit zgjerimin e tematikës së inspektimit sipas shkeljeve të konstatuara. Kryetari nëse e çmon të arsyeshme mbi bazën e fakteve dhe provave të paraqitura nga grupi i inspektimit, bën zgjerimi i tematikës së inspektimit duke amenduar Urdhërin e Inspektimit.
- 12.5 Faktet, provat, rezultatet e inspektimit dhe masat administrative/ gjobat e mundshme, evidentohen nga grupi i inspektimit, në aktin e inspektimit.
- 12.6 Inspektorët në përbërje të grupit të inspektimit, janë të detyruar të nënshkruajnë aktin e inspektimit dhe fletën e gjobës. Në rast të një qëndrimi jo unanim brenda grupit mbi faktet, provat, rezultatet e inspektimit dhe masat administrative përkatëse, secili nga inspektorët shkruan në aktin e inspektimit opinionit e tij të arsyetuar dhe nënshkruan me rezervë.
- 12.7 Gjoha dhe propozimi i masave administrative nga grupi i inspektimit, vendosen vetëm në rast se shumica e anëtarëve në përbërje të grupit të tij janë dakord me vendosjen e saj.
- 12.8 Përfaqësuesi i autorizuar i sipërmarrësit/subjektit vihet në dijeni me përmbajtjen e aktit të inspektimit dhe e nënshkruan atë me ose pa rezervë, në varësi të qëndrimit që vendos të mbajë kundrejt aktit dhe rezultateve të inspektimit.
- 12.9 Refuzimi i nënshkrimit me ose pa rezervë i aktit të inspektimit nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të sipërmarrësit/subjektit, nuk përbën kusht pengues për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës nga grupi i inspektimit dhe AKEP.

Neni 13

Akti i inspektimit

- 13.1 Akti i inspektimit përpilohet nga kryetari i grupit të inspektimit në bashkëpunim me inspektorët në përbërje të grupit dhe nënshkruhet nga palët (grupi i inspektimit dhe përfaqësuesi i autorizuar i sipërmarrësit/subjektit)

në prani të sipërmarrësit/subjektit të inspektuar, duke evidentuar në mënyrë kronologjike, veprimet e kryera nga inspektorët për kryerjen e inspektimit sipas tematikës së përcaktuar në Urdhërin e Inspektimit, të gjitha faktet e konstatuara dhe provat, metodikën e zbatuar, rezultatet e inspektimit, vendosjen e masave administrative (gjyba ose propozimet sipas pikës 2 të nenit 135 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar), si dhe rekomandimet përkatëse për rregullimin e shkeljeve të vërtetuara.

- 13.2 Shkeljet e vërtetuara përshkruhen në mënyrë të arsyetuar në referencë me bazën ligjore respektive dhe rekomandimet përkatëse shoqërohen me afate për rregullimin e tyre. Afatet vendosen mbi bazën e parimit të proporcionalitetit midis rëndësisë dhe pasojave të shkeljes, mbrojtjes së interesave të përdoruesve dhe, mundësisë reale të sipërmarrësi për rregullimin e tyre.
- 13.3 Akti i inspektimit mbahet në 2(dy) ekzemplarë origjinalë sipas Shtojces 1. Një ekzemplar origjinal i dorëzohet sipërmarrësit/subjektit dhe tjetri i paraqitet drejtorit të drejtorisë, sëbashku me praktikën e plotë të inspektimit të kryer.

Neni 14

Provat

- 14.1 Gjatë inspektimit, me cilësinë e provës inspektorët mund të kërkojnë nga përfaqësuesi i autorizuar i sipërmarrësit/subjektit dhe administrojnë, çdo dokument, pajisje, dhe shpjegime nga ana e tij dhe/ose punonjësve të sipërmarrësit/subjektit të dokumentuara me shkrim.
- 14.2 Inspektorët në përbërje të grupit të inspektimit, me cilësinë e provës mund të kryejnë fotografime të ambjenteve, pajisjeve dhe çdo sendi tjetër që ka lidhje me inspektimin në ambientet dhe zonën ku ushtron aktivitetin sipërmarrësi.
- 14.3 Fotografimet sipas paragrafit 2 të këtij neni duhet të tregojnë datën dhe orën e kryerjes së tyre nga grupi i inspektimit. Këto fotografime duhet të bëhen në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të sipërmarrësit/subjektit që inspektohet.
- 14.4 Provat sipas këtij neni, merren në dorëzim nga grupi i inspektimit me procesverbal, i cili nënshkruhet edhe nga përfaqësuesi i autorizuar i sipërmarrësit/subjektit.
- 14.5 Provat bëhen pjesë e praktikës së inspektimit përkatës. Ato ruhen dhe administrohen sipas ligjit të arkivave si dhe në respektim të mbrojtjes së të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi dhe ruajtjen e konfidencialitetit të sekretit tregtar.

Neni 15
Dorëzimi i praktikës së inspektimit

- 15.1 Kryetari i grupit të inspektimit, në përfundim të afatit të përcaktuar në Urdhërin e Inspektimit, i dorëzon drejtorit të drejtorisë dosjen e inventarizuar të inspektimit të kryer.
- 15.2 Dosja e inspektimit përmban:
- a) Kopje të Urdhërit të inspektimit;
 - b) Aktin e inspektimit;
 - c) Provat e siguruar gjatë inspektimit;
 - d) Kopje të fletës së gjobës ose propozimit për masa administrative sipas nenit 135 të ligjit nr. 9918, date 19.5.2008 i ndryshuar,(nese do te kete);
 - e) Shkresën bashkëshoqëruese të përpiluar nga kryetari i grupit të inspektimit.
- 15.3 Drejtori i drejtorisë, njihet me praktikën e dorëzuar dhe brenda dy (2) ditë pune pas marrjes së saj në dorëzim, nëpërmjet Kabinetit ia paraqet atë Kryetarit së bashku me opinionin e tij.
- 15.4 Drejtori i Drejtorisë përgjegjëse për inspektimin përgatit dhe paraqet para Këshillit Drejtues një herë në muaj një relacion në lidhje me konkluzionet e akteve të inspektimit të kryera në muajin paraardhës.

Neni 16
Blokimi i pajisjeve

- 16.1 Grupi i inspektimit, bllokoi pajisjet kur gjatë inspektimit vërtetohet se sipërmarrësi/subjekti zhvillon aktivitet në fushën e komunikimeve elektronike i pa-autorizuar nga AKEP sipas ligjit nr. 9918 i ndryshuar. Pajisjet e bllokuara inventarizohen dhe sekuestrohen. Një kopje e inventarit i dorëzohet sipërmarrësit/subjektit.
- 16.2 Nëse, brenda 30(tridhjetë) ditëve nga data e bllokimit, sipërmarrësi/subjekti nuk vepron për të legjitimuar ushtrimin e aktivitetit në përputhje me ligjin nr.9918 i ndryshuar, atëhere pajisjet i kalojnë për shitje organeve/subjekteve të ngarkuara me ligj ose akte nënligjore.
- 16.3 Kur, gjatë inspektimit inspektorët vërtetojnë se pajisjet radio të sipërmarrësit/subjektit, shkaktojnë interferenca të dëmshme, pavarësisht se për përdorimin e tyre është marrë autorizimi përkatës, mund të bëjnë ndalimin e funksionimit të mëtejshëm të tyre deri në një afat të caktuar në aktin e inspektimit. Në çdo rast, ky afat nuk mund të jetë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e ndalimit të funksionimit të tyre.
- 16.4 Nëse brenda këtij afati, sipërmarrësi/subjekti nuk vepron për të rregulluar të metat e evidentuara sipas rekomandimeve të inspektorëve, atëhere

veprohet duke vendosur bllokimin e përhershëm të tyre dhe mund të inventarizohen dhe sekustrohen sipas parashikimeve të këtij neni.

- 16.5 Ndalimi i funksionimit të përkohshëm të pajisjeve kryhet duke i bllokuar dhe vulosur pajisjet me vulë të veçantë të institucionit.

KREU III MONITORIMI

Neni 17 Qellimi i Monitorimit

- 17.1 AKEP-i monitoron spektrin e frekuencave të caktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave me qëllim që:
- a) Përdorimi i frekuencave të dhëna me autorizim të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të autorizimit;
 - b) Spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar, sipas dispozitave të ligjit 9918, I ndryshuar;
 - c) Të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit radio, që do të përdoren për qëllime private ose publike;
 - d) Te ofroje te dhena te vlefshme per procesin e administrimit te spektrit lidhur me perdorimin aktual te kanaleve te frekuencave dhe brezave te frekuencave, verifikimin e karakteristikave teknike reale te sinjaleve te transmetuara;
 - e) Te ofroje informacione te monitorimit per kerkesat per asistencë te vecante te administratave te vendeve fqinje ne eliminimin e interferencave te demshme, si dhe identifikimin e pastrimin e transmetimeve jashte brezi.
- 17.2 Monitorimi i frekuencave mund të bëhet edhe me kërkesë të subjekteve, të cilat zotërojnë një autorizim të lëshuar nga AKEP-i.

Neni 18 Organizimi i Monitorimit

- 18.1 Monitorimi i spektrit te frekuencave kryhet nga Sektori i Monitorimit te Spektrit te Frekuencave dhe Interferencave, ne perberje te Drejtorise se Monitorimit te Frekuencave, Cilesise dhe Inspektimeve (DMFCI).

- 18.2 Plani i punes, parashikon nje kontroll periodik te pikave kryesore te transmetimit ne RSH dhe sistematik te zbatimit te kushteve te perdorimit te frekuencave nga subjektet e autorizuar per perdorim te tyre, identifikimin e perdoruesve te pa autorizuar te frekuencave, ndjekjen e ankesave per interference dhe identifikimin e burimeve te shqetesimeve, bashkepunimin me Drejtoria e Administrimit të Frekuencave Numeracionit dhe Autorizimeve(DAFNA) per perditesim te bazes se te dhenave mbi perdorimin e spektrit te frekuencave, si dhe mbeshtetje te kesaj Drejtorie gjate procesit te caktimit te frekuencave.
- 18.3 Personeli qe kryen matje per monitorimin e spektrit te frekuencave perbehet nga jo me pak se dy vete. Per kryerjen e matjeve perdoret Qendra e Levizshme e Monitorimit te Spektrit te Frekuencave - QLMSF, si dhe cdo pajisje tjeter e disponueshme.

Neni 19 Veprimtaria e Monitorimit

- 19.1 Veprimtaria e personelit te monitorimit organizohet nga Pergjegjesi i Sektorit dhe koordinohet nga Drejtori i Drejtorise se Monitorimit te Frekuencave, Cilesise dhe Inspektiveve.
- 19.2 Monitorimi mund te kryhet ne cdo kohe dhe ne cdo ambjent, ne perputhje me parashikimet e ligjit 9918, i ndryshuar.
- 19.3 Cdo pengese per kryerjen e detyres se monitorimit perben kundravajtje administrative dhe do te ndeshkohet sipas parashikimeve te ligjit nr. 9918, date 19.5.2008 " Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, si dhe do te njoftohen organet e Policise se Rendit per bashkeveprim/mbeshtetje sipas ligjit, ose do te bashkepunohet me autoritetet publike vendore ne perputhje me termat e marreveshjes se bashkepunimit me keto institucione .

Neni 20 Aksesi ne bazen e te dhenave

- 20.1 Personeli i monitorimit te spektrit te frekuencave do te kete akses ne bazen qendrore te te dhenave te perdoruesve te pajisur me Autorizim Individual per t'i dhene mundesine e verifikimit te kushteve te Autorizimit dhe identifikimit te perdoruesave te pa-autorizuar.

NP nënkupton: nuk mund të matet qoftë as nga inspektimi në-vend dhe as nga monitorimi; duhen aplikuar mjete të tjera, të tillë si monitorimi i lëvizshëm për mbulimin ose helikopteri për diagramën ekzakte të antenës.

Neni 22

Instrukcionet dhe autorizimi për monitorim

- 22.1 Përdorimi i pajisjeve të monitorimit bëhet në përputhje me instruksionet që përshkruajnë rrjedhën e punës dhe procedurat standarde të matjeve.
- 22.2 Instruksionet hartohen nga sektori i monitorimit, duke u bazuar në Manualin e Monitorimit (Monitoring Handbook - ITU) dhe manualin e pajisjeve që përbejnë QLMSF.
- 22.3 Dalja në terren dhe kryerja e matjeve bëhet vetëm mbasi grupi i matjeve të jetë pajisur me Autorizimin e kryerjes së monitorimit. Asnjë person nuk mund të dalë për kryerjen e matjeve pa qenë i pajisur me Autorizimin e kryerjes së monitorimit.

Neni 23

Kryerja e matjeve

- 23.1 Çdo dalje në terren të QLMSF, e autorizuar për kryerjen e matjeve, mban në konsideratë që:
 - a) grupi i lëvizshëm i monitorimit të qëndrojnë në zonë deri në përfundim të matjeve duke shmangur kthimin mbrapsh çdo ditë, për të menjancuar koston shtesë dhe për shfrytëzim racional të kohës;
 - b) çdo anëtar i grupit duhet të ketë të qarta detyrat që përpara nësjes, mjetin që do të përdoret dhe vendin ku do të kryhen matjet.

Neni 24

Vlerësimi i matjeve dhe veprimet e nevojshme

- 24.1 Në varesi të rezultateve të matjeve, personeli i përfshirë analizon situatën dhe nëse konstaton përdorime të frekuencave në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator, merr masat e nevojshme në përputhje me nenin 134 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
- 24.2 Grupi i monitorimit mban proces-verbal, ku përshkruhen konkluzionet e arritura dhe masat e vendosura. Ky proces-verbal (Shtojca 3) firmoset në dy kopje origjinale nga grupi i monitorimit dhe zotëruesi i pajisjeve që shkaktonin shqetësim.

- 24.3 Zoteruesi i pajisjeve eshte i lire te shenoje vrejttet e tij ne proces-verbal, kur ai e gjykon te nevojshme nje gje te tille. Nje kopje e tij dhe rezultatet e matjeve, kur eshte e nevojshme, i lihet zoteruesit te pajisjeve.

Neni 25

Raporti i monitorimit

- 25.1 Ne perfundim te cdo procesi matjesh dhe monitorimi, personeli i perfshire ne matje pergatit raportin e monitorimit, me permbajtje si me poshte :
- a) pershkrim i qellimit dhe detyres;
 - b) personeli i perfshire ne detyre;
 - c) data dhe koha gjate se ciles eshte kryer detyra;
 - d) pajisjet dhe antenat qe jane perdorur per matjet dhe monitorim;
 - e) vlerat e matura te frekuences, gjeresia e brezit, mbulimi, Okupimi Brezit të Frekuencave (FBO), Okupimi i Kanalit të Frekuencave (FCO), densiteti i fluksit te fuqise, intensiteti i fushes, shenja e thirrjes, analize e sinjalit, dhe shkeljet, nqs ka te tilla;
 - f) printime me pamje nga analizatori i spektrit;
 - g) kushtet mjedisore te cilat mund te ndikojne saktesine e matjeve;
 - h) konkluzionet dhe rekomandime per veprime te metejshme, kur eshte e nevojshme.
- 25.2 Raporti firmoset nga te gjithë antaret e grupit te monitorimit. Cdo antar ka te drejte te shtoje vrejttet e tij per pika te vecanta apo per te gjithë raportin, kur nuk eshte dakord me ate, duke arsyetuar cdo vrejtte te paraqitur.

Neni 26

Baza e te dhenave te monitorimit

- 26.1 Me qellim ruajtjen e te dhenave dhe perpunimin efektiv te tyre, te gjitha te dhenat e monitorimit ruhen ne nje baze te vecante te dhenash. Permbajtja e bazes se te dhenave eshte kryesisht si me poshte:
- a) numri unik i detyres;
 - b) kodi per llojin e detyres (raport interference, matje te okupimit te spektrit dhe te tjera sipas percaktimit te pikes 21.2 te kesaj rregullore);
 - c) te dhenat per subjektin qe kerkon detyren ose raportuesin e interferences duke perfshire dresen, numrin e telefonit dhe faksit, adresen e e-mailit;
 - d) identifikimin e vendit ku kryhen matjet;
 - e) pershkrimi i detyres ose permbajtja e raportit;
 - f) sherbimi apo pajisja e perdorur;
 - g) frekuenca;
 - h) shenja e thirrjes;
 - i) kategoria e stacionit (fiks, i levizshem);
 - j) te dhena ne lidhje me pajisjet, te tilla si, prodhuesi, numri serial, etj.;

k) emrat e personave te perfshire ne proces.

Neni 27 **Sigurimi teknik gjate matjeve**

- 27.1 Pergjegjesi i grupit te matjeve eshte pergjegjes per zbatimin e rregullave te sigurimit teknik.
- 27.2 Ndalohet nxjerrja ne operim dhe kryerja e matjeve ne kushte te renda atmosferike, vecanerisht ne rastet e shkarkimeve atmosferike.
- 27.3 Ne cdo rast, gjate realizimit te matjeve stacionare duhet bere tokezimi i QLMSF ne perputhje me rregullat e tokezimit.
- 27.4 Stafi perdorues i QLMSF nuk duhet te qendroje prane pjeseve te cilat mund te behen objekt goditje me pasoje demtimin e shendetit.
- 27.5 Nuk lejohet kryerja e matjeve nese QLMSF nuk eshte vendosur ne kushte optimale per realizimin e matjeve.
- 27.6 Montimi i antenave te nevojshme per kryerjen e matjeve behet ne perputhje me udhezimet e perdorimit per secilen pajisje.
- 27.7 Kycja dhe ckycja e burimit te ushqimit (energji elektrike) per qendren e levizshme te monitorimit behet ne perputhje me instruksionet e percaktuara ne manualin e perdorimit.
- 27.8 Levizja e automjetit behet vetem pasi te jete siguruar qe cdo pajisje eshte ne vendin e duhur dhe se levizja e automjetit nuk perben rrezik per demtimin e pajisjeve.

KREU IV **PLANIFIKIMI I INSPEKTIMIT DHE MONITORIMIT**

Neni 28 **Kryerja e Inspektimit dhe monitorimit**

- 28.1 Inspektimi kryhet mbi bazën e një Urdhëri Inspektimi të nxjerrë nga Kryetari, rast pas rasti, sipas planit të detajuar mujor të inspektimit.
- 28.2 Monitorimi kryhet mbi bazën e një Autorizim Monitorimi të nxjerrë nga Kryetari, rast pas rasti, sipas planit te monitorimit.
- 28.3 Ne rastet e parashikuar ne piken 30.4 inspektimi dhe monitorimi kryhen mbi bazen e nje Urdheri te Integruar te Inspektimit dhe Monitorimit

Neni 29
Planifikimi i Integruar i Inspektimeve dhe Monitorimeve

- 29.1 Në fund të çdo muaji pararendës Kryetari miraton planin e detajuar të inspektimit dhe monitorimit për muajin pasardhës, të paraqitur nga drejtoria DMFCI.
- 29.2 DMFCI, ne fund të çdo muaji pararendës dorëzon në Kabinet për miratim nga Kryetari, planin e integruar të inspektimit dhe monitorimit për muajin pasardhës.
- 29.3 Plani i Integruar i Inspektimit dhe Monitorimit (PIIM) përmban:
- a) Sipërmarrësit e planifikuar të inspektohen gjatë muajit pasardhës
 - b) Tematikat dhe objektet e inspektimit, ne zbatim të detyrimeve ligjore dhe akteve rregullatore të nxjerra nga AKEP.
 - c) Afatin e kryerjes së inspektimit
 - d) Pikat e transmetimit qe do te monitorohen, te cilat perfshihen ne zonen gjeografike te sipermarresve te parashikuar per inspektim, per te kryer nje kontroll sistematik te zbatimit te kushteve te perdorimit te frekuencave nga subjektet e autorizuar per perdorim te tyre dhe identifikimin e perdoruesve te pa autorizuar te frekuencave ne keto zona gjeografike.

Neni 30
Urdhëri i Inspektimit dhe Autorizimi i Monitorimit

- 30.1 Për zbatimin e Planit te Integruar te Inspektimit dhe Monitorimit, Kryetari rast pas rasti nxjerr Urdhërin e Inspektimit dhe Autorizimin e Monitorimit.
- 30.2 Urdhëri i Inspektimit përmban:
- a) Emrin dhe adresën e sipërmarrësit dhe/ose subjektit që do të inspektohet;
 - b) Tematikën e inspektimit;
 - c) Bazën ligjore;
 - d) Listën emërore të inspektorëve në përbërje të grupit të inspektimit;
 - e) Datën e fillimit të inspektimit dhe afatin e përfundimit të tij.
- 30.3 Autorizimi i Monitorimit përmban:
- a) Pikat e transmetimit qe do te monitorohen, te cilat perfshihen ne zonen gjeografike te sipermarresve te parashikuar per inspektim,
 - b) Listën emërore të specialisteve te Monitorimit,
 - c) Llojin e matjeve qe do te kryhen
 - d) Datën e fillimit të monitorimit dhe afatin e përfundimit të tij.
 - e) pershkrim i qellimit dhe detyres;
 - f) pajisjet dhe antenat qe do te perdoren per matjet;
- 30.4 Ne rastet kur ne zonen gjeografike te sipermarresve te parashikuar per inspektim perfshihen pikat e transmetimit qe monitorohen periodikisht,

urdhri i inspektimit dhe monitorimit, eshte nje Urdher i Integruar Inspektimi dhe Monitorimi dhe permban te gjitha percaktimet sipas pikave 30.2 dhe 30.3 te mesiperme.

30.5 Projekt-Urdheri i Inspektimit dhe Monitorimit hartohet nga DMFCI.

Neni 31

Tematika e inspektimit dhe monitorimit

- 31.1 Tematika e inspektimit dhe monitorimit, planifikohet dhe përcaktohet rast pas rasti duke patur parasysh qëllimin e inspektimit dhe monitorimit, sipërmarrësit dhe/ose subjektet që do të inspektohen, shërbimet që ofrojnë, problematikën e njohur si dhe masat e karakterit preventivuese për parandalimin e shkeljeve të mundshme të ligjit nr. 9918 i ndryshuar dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij.
- 31.2 Tematikat përcaktohen, rast pas rasti, bazuar ne raportet mujore që cdo sektor i AKEP dërgon pranë zyres së Koordinimit të Inspektimeve, pas verifikimeve të kryera sistematikisht (inspektim ne distance) mbi detyrimet e sipërmarrësve ne lidhje me:
- I. Permbushjen e detyrimit të sipërmarrësit për ndryshimet ne autorizim dhe reflektimi i të dhënave, si ndryshime ne QKR, etj (*Sektori i Autorizimeve,*)
 - II. Permbushjen e detyrimit të sipërmarrësit për raportimet, tarifat, ndertimin e faqes web, trajtimi i ankesave të përdoruesit, speetest, etj (*Sektori i Tregjeve, Mbikqyrjes sipërmarrësve me FNT dhe Sektorit Sigurimit Shërbimit Universal dhe Tarifave*)
 - III. Permbushjen e detyrimit të sipërmarrësit për zbatimin e portabilitetit të numrit dhe problematika të tjera ne lidhje me administrimin e domain .al (*Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Aplikacioneve*)
 - IV. Permbushjen e detyrimit të sipërmarrësit për reflektimin ne sistemin ATLAS të infrastruktures kabllore dhe radio, raportimet e treguesve të cilësive dhe regjistrimin e frekuencave që përdoren pa Autorizim Individual (*Sektori i monitorimit të cilësisë*)
 - V. Problemetikat që lidhen me pagesat pranë AKEP, debitoret etj (*Sektori i Menaxhimit Financiar dhe sektori i Pagesave dhe Statistikave*)
 - VI. Permbushjen e detyrimit të sipërmarrësit për ofrimin e shërbimit postar dhe mbi problemetikat që lidhen me shërbimin postar (*Sektori i Shërbimit Postar*).

Neni 32

Grupi i inspektimit dhe monitorimit

- 32.1 Grupi i inspektimit, në çdo rast përbëhet nga jo më pak se 3(tre) inspektorë me të drejta dhe përgjegjësi të barabarta ligjore për realizimin e detyrës sipas Urdhërit të Inspektimit dhe kësaj rregulloreje.

- 32.2 Grupi i monitorimit, në çdo rast përbëhet nga jo më pak se 2(dy) specialiste te monitorimit te frekuencave, me të drejta dhe përgjegjësi të barabarta ligjore për realizimin e detyrës sipas Autrozimit te Monitorimit dhe kësaj rregulloreje.
- 32.3 Ne rastet kur ne zonen gjeografike te sipermarresve te parashikuar per inspektim perfshihen pikat e transmetimit qe monitorohen periodikisht, grupi i inspektimit dhe monitorimit perbehet nga 5 (pese) persona, minimumi 2 (dy) prej te cileve jane specialiste te sektorit te monitorimit te frekuencave.
- 32.4 Në Urdhërin e Inspektimit, një ndër anëtarët e grupit përcaktohet kryetari i grupit, i cili në bashkëpunim me anëtarët e tjerë, përpilon aktin e inspektimit dhe plotëson fletën e gjobës nëse do të vendoset një e tillë.
- 32.5 Ne rastet kur subjekti/sipermarresi qe Inspektohet eshte perdorues i frekuencave eshte e detyrueshme qe nje anetar i grupit te jete nga sektori i Monitorimit te frekuencave dhe interferencave.
- 32.6 Ne rastet kur subjekti/sipermarresi qe Inspektohet eshte ofrues i sherbimit postar eshte e detyrueshme qe nje anetar i grupit te jete nga sektori i Shërbimit Postar

KREU V

Neni 33

Kundërvajtjet administrative

- 33.1 Nëse gjatë inspektimit, vërtetohet se sipërmarrësi/subjekti ka shkelur ligjin nr. 9918, i ndryshuar dhe/ose aktet nënligjore dhe rregulloret në zbatim të tij, në varësi të natyrës së shkeljes, dëmit të shkaktuar ose që mund të sjellë për rrjedhojë, sjelljen e sipërmarrësit/subjektit, si dhe duke patur parasysh zbatimin e parimeve të sanksionuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin për kundërvajtjet administrative, kur shkelja/et nuk përbëjnë vepër penale, grupi i inspektimit propozon ose vendos sanksione administrative të shoqëruara me afate dhe rekomandime për rregullimin e shkeljes.
- 33.2 Sanksionet administrative që grupi i inspektimit vendos drejtpërdrejt ose i prozon Këshillit Drejtues të AKEP-it sipas pikës 1 dhe 2 të nenit 135 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar mund të jenë:
- I propozojnë Këshillit Drejtues të AKEP-it masën e gjobës, sipas nenit 137 pika 1 të këtij ligji, për shkeljet e parashikuara në paragrafët I deri në IV të tij, dhe masat për ndreqjen e shkeljes së konstatuar;
 - Vendosin gjobë, sipas nenit 137 pika 1 të këtij ligji, për shkeljet e parashikuara në paragrafët V deri në VIII të tij dhe kërkojnë marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes, duke vendosur një afat për realizimin e saj;

- c) Propozim për heqjen e së drejtës së përdorimit të frekuencave /numeracionit;
- d) Propozim për heqjen e të drejtës së ofrimit të shërbimeve rrjeteve të komunikimeve elektronike.

Neni 34

Propozimet për sanksione administrative

- 34.1 Grupi i inspektimit mbi bazën e provave dhe fakteve të grumbulluara, në përfundim të inspektimit arrin në konkluzionin se sipërmarrësi/subjekti me veprimet e kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë ka shkelur ligjin nr. 9918 i ndryshuar dhe/ose aktet nënligjore dhe rregulloret në zbatim të tij, nisur nga karakteri i shkeljes, dëmi dhe pasojat e shkeljes si dhe historia e sjelljes së tij në raport me kuadrin ligjor, ka të drejtë t'i propozojë Këshillit Drejtues të AKEP sanksionet administrative të parashikuara në pikën 2 të nenit 135 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar.
- 34.2 Këshilli Drejtues i AKEP, mbi bazën e dosjes së inspektimit, shpjegimeve me shkrim ose verbale të sipërmarrësit/subjektit në seancën dëgjimore, në lidhje me sanksionet e propozuara nga grupi i inspektimit, vendos:
 - a) Të paralajmërojë sipërmarrësin, me shkrim, duke përcaktuar shkeljen e bërë; ose,
 - b) Të miratojë propozimin e grupit të inspektimit.
- 34.3 Ndaj vendimit të Këshillit Drejtues për vendosjen e masave administrative të propozuara nga grupi i inspektimit, mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit

Neni 35

Gjobat

- 35.1 Kur shkeljet e vërtetuara nga grupi i inspektimit përbëjnë kundravajtje administrative, përveçse është parashikuar në nenin 33 të kësaj rregulloreje, sipas rastit dhe karakterit të kundërvajtjes administrative, dënohen me gjobë në përputhje me nenin 137 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar.
- 35.2 Rast shkelje i përcaktuar në pikat VII dhe VIII, të nenit 137 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar, do të çliësohet çdo shkelje e rregulloreve të miratuara dhe publikuara nga AKEP.
- 35.3 Masa e gjobës, caktohet nga grupi i inspektimit duke patur parasysh zbatimin rigoroz të kompetencave dhe objektivave rregullatore të AKEP, natyrën dhe rëndësinë e shkeljes, dëmin e shkaktuar, mbrojtjen e interesave

- të përdoruesve, parimet e sanksionuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe sjelljen e sipërmarrësit/subjektit.
- 35.4 Gjoha, vendoset nga grupi i inspektimit menjëherë në përfundim të inspektimit dhe aktit të inspektimit në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të sipërmarrësit/subjektit.
- 35.5 Gjoha pritët në tre kopje sipas formularit të miratuar në Shtojcën 2 të rregullores. Një kopje e gjobës i jepet sipërmarrësit/subjektit dhe një kopje i përcillet Kryetarit nëpërmjet drejtorit të DMFCI së bashku me dosjen e inspektimit.
- 35.6 Për procedurë, Kryetari ia kalon fletën e gjobës Drejtorisë të Financës, Pagesave dhe Statistikës, e cila komunikon menjëherë me sipërmarrësin/subjektin e penalizuar (gjobitur) me qëllim arkëtimin e gjobës.
- 35.7 Gjoha është titull ekzekutiv dhe duhet të paguhet nga subjekti menjëherë brenda dhjetë (10) ditëve pas marrjes së njoftimit, përveçse kur subjekti në rrugë administrative e ankimon vendimin e grupit të inspektimit për gjobën.
- 35.8 Ankimimi i sipërmarrësit/subjektit të penalizuar sipas procedurës së përcaktuar në nenin 136 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar për gjobën, pezullon veprimet për arkëtimin e gjobës deri në nxjerrjen e vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimit.
- 35.9 Nëse sipas vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it, gjoha mbetet në fuqi, atëherë njëkohësisht me njoftimin që kryhet për sipërmarrësit/subjektin, Kryetari urdhëron arkëtimin e gjobës nga Drejtorisë të Financës, Pagesave dhe Statistikës të AKEP-it, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga sipërmarrësi/subjekti të vendimit të Këshillit Drejtues për ankimin.
- 35.10 Ankimi i sipërmarrësit/subjektit të penalizuar kundra vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it për gjobën në Gjykatën kompetente, nuk e pezullon arkëtimin e gjobës përveçse kur Gjykata shprehet me vendim për pezullimin e saj deri në marrjen e vendimit përfundimtar sipas Kodit të Procedurës Civile.
- 35.11 Nëse Gjykata kompetente nuk shprehet me vendim për pezullimin e gjobës siç përcaktohet në pikën e mësipërme, sipërmarrësi/subjekti është i detyruar të paguajë gjobën brenda dhjetë (10) ditëve pas marrjes së vendimit të Gjykatës për mospezullimin e saj.
- 35.12 AKEP-i me marrjen e njoftimit për mospranimin e pezullimit të gjobës nga Gjykata, nëpërmjet Drejtorisë të Financës, Pagesave dhe Statistikës i kërkon sipërmarrësit/subjektit të penalizuar arkëtimin e gjobës sipas afatit të caktuar në pikën 25.10 të këtij neni.
- 35.13 Nëse sipërmarrësi/subjekti i penalizuar nuk paguan gjobën sipas afateve të parashikuara në çdo rast në pikat 25.6, 25.8 dhe 25. 10, atëherë Drejtorisë të Financës, Pagesave dhe Statistikës informon Kryetarin dhe njëkohësisht i drejtohet me shkrim DMFCI për kryerjen e veprimeve të mëtejshme ndaj

sipërmarrësit/subjektit të penalizuar sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 10 279, deri në ekzekutimin e detyrimit nga ana e sipërmarrësit/subjektit.

- 35.14 DMFCI, nepermjet zyres se koordinimit te inspektiveve, eshte pergjegjese per ekzekutimin e detyrimit (gjobës) nga sipërmarrësi/subjekti i penalizuar, zbaton rigorozisht procedurën ligjore sa më sipër dhe nëse deri 30 (ditë) përpara afatit të parashkrimit të gjobës sipas nenit 46 të ligjit nr. 10 279 gjoba nuk është arkëtuar, atëhere me shkresë, kjo drejtori informon Kryetarin dhe njëkohësisht i drejtohet Drejtoria e Shërbimeve ligjore dhe Mbrojtjes së përdoruesve (DSHLPM), fillimin e veprimeve ligjore për ndjekjen e çështjes në rrugë gjyqësore në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.
- 35.15 Mospagesa e gjobës nga ana e sipërmarrësit/subjektit i jep të drejtë AKEP-it që të mos i ofrojë shërbimet e parashikuara në ligjin nr. 9918 i ndryshuar deri në shlyerjen e detyrimit.
- 35.16 Në rastet kur një rrethanë financiare pengon sipërmarrësin/subjektin për të paguar plotësisht dhe në afat masën e gjobës, ai mund të lidhe marrëveshje pagese me këste me AKEP-in sipas procedurës së përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 10 279.

Neni 36

Ankimi ndaj gjobave

- 36.1 Vendimi për vendosjen e gjobës është një akt administrativ individual i ankimueshëm në rrugë administrative pranë Këshillit Drejtues të AKEP-it.
- 36.2 Ankimi administrativ ndaj gjobës duhet të bëhet nga sipërmarrësi/subjekti brenda 10(dhjetë) ditëve nga data e dhënies së saj.
- 36.3 Afati i shqyrtimit të ankimit nga Këshilli Drejtues është brenda 30(tridhjetë) ditëve pas regjistrimit të tij në protokollin e AKEP-it.
- 36.4 Përpara marrjes së vendimit, Këshilli Drejtues zhvillon seancë dëgjimore me sipërmarrësin/subjektin, me qëllim që t'i japi atij mundësinë për të parashtruar shpjegimet, pretendimet dhe kërkesat. Shpjegimet, pretendimet dhe kërkesat mund të paraqiten në seancën dëgjimore me shkrim ose në mënyrë verbale.
- 36.5 Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli Drejtues shprehet me vendim të arsyetuar dhe bazuar ligjërisht duke vendosur për:
- a) Të paralajmërojë sipërmarrësin me shkrim, duke përcaktuar shkeljen e bërë;
 - b) Të miratojë propozimin e inspektorëve;
- 36.6 Kundër vendimit të Këshillit të Drejtues të AKEP mund të bëhet ankimi, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit, në gjykatën e rrethit, ku është kryer kundërvajtja.

Neni 37

Veprimet "kryesisht"

- 37.1 AKEP, mund të vendosë sanksione administrative ndaj sipërmarrësve/subjekteve edhe "kryesisht", nëse gjatë veprimeve të kryera nga ana e tij vërteton se subjekti ka shkelur ligjin nr. 9918 i ndryshuar, aktet nënligjore dhe rregulloret në zbatim të tij.
- 37.2 Në rastet e veprimeve "kryesisht" AKEP, përpara marrjes së vendimit për vendosjen e sanksionit administrativ mund të kërkojë nga sipërmarrësi/subjekti shpjegime me shkrim ose verbalisht në një seancë dëgjimore.
- 37.3 Procedura e ankimit administrativ në rastet e vendimeve për vendosje gjobe "kryesisht" është e njëjtë me atë të përshkruar në nenin 26 të kësaj rregulloreje.
- 37.4 Në rastet e vendosjes së sanksioneve administrative "kryesisht", sipas pikës 2 të nenit 136 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar, ankimi mund të bëhet në Gjykatën kompetente.

Neni 38

Shfuqizimi

Rregullorja Nr. 1516, datë 31. 01. 2011 "Për inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe kundërvajtjet administrative" shfuqizohet.

Neni 39

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas miratimit nga Këshilli Drejtues.

Shtojca 1 (Model)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

AKT INSPEKTIMI

Nr. _____, datë _____

Sot më datë _____, në ambjentet e sipërmarrësit/subjektit _____/AKEP,

bazuar në nenin _____ të Rregullores Nr. __, date __.__.__ së AKEP “Për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative” të AKEP (ketu e më poshtë Rregullore Nr. __. datë __.__.__), nga dhe midis palëve,

1. Grupit të inspektimit të AKEP të përbërë nga:

_____ (Inspektor/Kryetar)

_____ (inspektor)

_____ (inspektor) dhe;

2. Përfaqësuesit të autorizuar të sipërmarrësit/subjektit _____,

përpilohet ky akt inspektimi, si më poshtë vijon:

I. Hyrje

1. Në zbatim të Urdhërit të Inspektimit Nr. _____, datë _____, grupi i inspektimit të AKEP, më datë _____, ora: _____, u paraqit pranë sipërmarrësit/subjektit _____ për kryerjen e inspektimit me tematike:

_____.

2. Sipërmarrësi/subjekti ishte njoftuar paraprakisht/nuk ishte njoftuar për kryerjen e këtij inspektimi.

3. Përfaqësuesit i autorizuar i sipërmarrësit/ subjektit Z/Znj _____, iu dorëzua kopja e Urdhërit të Inspektimit dhe iu kërkua që për kryerjen e inspektimit t’iu krijoheshin kushtet e nevojshme në përputhje me nenin _____, të Rregullores.

4. Gjatë inspektimit, grupi i inspektimit u shoqërua nga Z/Znj _____, përfaqësues i autorizuar i sipërmarrësit/subjektit _____ dhe/ose punonjësi _____.

II. Veprimet e kryera

Grupi i inspektimit për zbatimin e detyrave në përputhje me Urdhërin e Inspektimit kreu këto veprime:

III. Konstatimet

Gjatë inspektimit u konstatua:

IV. Provat dhe shpjegimet

Gjatë inspektimit, u siguruan këto prova:

_____ ;
dhe u dhanë shpjegimet nga përfaqësuesi i autorizuar i sipërmarrësit/subjektit _____ dhe/ose punonjesi _____ :

V. Konkluzionet

Përfundimisht, bazuar në faktet e konstatuara, provat dhe shpjegimet sa më sipër, parashikimet ligjore të përcaktuara në nenin _____, të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore _____, Rregullores Nr. __, date __. __. __, arrihet në përfundimin se:

VI. Detyrat

Për rregullimin e shkeljeve të konstatuara sipërmarrësit/subjektit i lihen këto detyra:

VII. Vendimi për sanksione administrative

Grupi i inspektimit, bazuar në nenin _____ të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, nenin _____ të Rregullores Nr. __, date __. __. __, duke patur parasysh _____,

VENDOSI:

VII. Shënime:

Kundra këtij akti, sipas nenit _____ të Rregullores, mund të bëhet ankim administrativ pranë Këshillit Drejtues të AKEP.

NENSHKRUAJNE

Grupi i inspektimit:

Për sipërmarrësin/subjektin:

Shtojca 2 (Model)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Nr.serial _____

GJOBË

Nr. _____, datë _____

Sipërmarrësit/Subjektit:

Në zbatim të Vendimit të grupit të inspektimit sipas Akt Inspektimi Nr. _____, datë _____, për shkelje:

_____;

të parashikuar si kundravajtje administrative në përputhje me pikën _____, të nenit 137 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 i ndryshuar, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë",

dënoheni me gjobë në masën _____.

Gjoha është titull ekzekutiv dhe duhet të paguhet nga subjekti menjëherë brenda dhjetë (10) ditëve pas marrjes së njoftimit, përveçse kur subjekti në rrugë administrative e ankimon vendimin e grupit të inspektimit për gjobën. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet kamatë 2 për qind në muaj të masës së gjobës.

Gjoha duhet të paguhet në Nr. e llogarisë të AKEP:

_____.

Kundra dënimit me gjobë, brenda 10 ditëve nga data e dhënies së saj, bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP.

Grupi i inspektimit:

Për Sipërmarrësin/subjektin:

Shtojca 3 (Model)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

AKT BLOKIMI DHE NDALIM FUNKSIONIMI TE PAJISJEVE

Sot më datë _____, në ambjentet e subjektit _____, bazuar në _____

Grupi i inspektim-monitorimit të AKEP i përbërë nga:

_____ (Inspektor/Kryetar)
_____ (inspektor)
_____ (inspektor), dhe

Përfaqësuesi i subjektit _____,

përpilojnë këtë akt bllokimi/ndalim funksionimi te pajisjeve, si më poshtë vijon:

Konstatimet:

Gjatë matjeve të kryera dhe kontrollit fizik të pajisjeve u konstatua se:

dhe u dhanë shpjegimet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit/punonjësi :

Konkluzionet

Përfundimisht, bazuar në faktet e konstatuara dhe shpjegimet sa më sipër, parashikimet ligjore të përcaktuara në nenet 65, 133 dhe 134, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 i ndryshuar, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, arrihet në përfundimin se:

Për rregullimin e shkeljeve të konstatuara rekomandojmë:

Vendimi për masat administrative

Grupi i inspektim-monitorimit, bazuar në nenin 134 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 i ndryshuar, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

VENDOSI:

Kundra këtij akti, sipas neneve 134 dhe 136 të ligjit nr.9918, i ndryshuar mund të bëhet ankim administrativ brenda 5 ditësh, pranë Këshillit Drejtues të AKEP dhe në Gjykatën kompetente.

Ky akt mbahet në dy kopje, njëra nga të cilat i dorëzohet subjektit.

NËNSHKRUAJNË

Grupi i inspektim-monitorimit

Për subjektin:

Shtojca 4 (Model)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

AKT INSPEKTIMI “PER SIPERMARRRESIT POSTARE”

Nr. _____, datë _____

Sot më datë _____, në ambientet e sipërmarrësit/subjektit _____/AKEP,

bazuar në nenin _____ të Rregullores nr. _____, date _____ së AKEP “Për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative” (këtu e më poshtë Rregullore Nr. _____, datë _____.)

1. Grupit të inspektimit të AKEP të përbërë nga:

_____ (Inspektor/Kryetar)

_____ (inspektor)

_____ (inspektor) dhe;

2. Përfaqësuesit të autorizuar të sipërmarrësit/subjektit _____,

përpilohet ky akt inspektimi, si më poshtë vijon:

I. Hyrje

1. Në zbatim të Urdhërit të Inspektimit Nr. _____, datë _____, grupi i inspektimit të AKEP, më datë _____, ora: _____, u paraqit pranë sipërmarrësit/subjektit _____ për kryerjen e inspektimit me tematikë:

_____.

2. Sipërmarrësi/subjekti ishte njoftuar paraprakisht/nuk ishte njoftuar për kryerjen e këtij inspektimi;

3. Përfaqësuesit i autorizuar i sipërmarrësit/ subjektit Z/Znj _____, i'u dorëzua kopja e Urdhërit të Inspektimit dhe i'u kërkua që për kryerjen e inspektimit t'iu krijoheshin kushtet e nevojshme në përputhje me nenin _____, të Rregullores Nr. _____, datë _____;

4. Gjatë inspektimit, grupi i inspektimit u shoqërua nga Z/Znj _____, përfaqësues i autorizuar i sipërmarrësit/subjektit _____ dhe/ose punonjësi _____.

II. Veprimet e kryera

Grupi i inspektimit për zbatimin e detyrave në përputhje me Urdhërin e Inspektimit kreu këto veprime:

III. Konstatimet

Gjatë inspektimit u konstatua:

IV. Provat dhe shpjegimet

Gjatë inspektimit, u siguruan këto prova:

_____ ;
dhe u dhanë shpjegimet nga përfaqësuesi i autorizuar i sipërmarrësit/subjektit _____ dhe/ose punonjesi _____ ;

V. Konkluzionet

Përfundimisht, bazuar në faktet e konstatuara, provat dhe shpjegimet sa më sipër, parashikimet ligjore të përcaktuara në nenin _____, të Ligjit nr. 8530, datë 23.9.1999 “Për Shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, aktet nënligjore _____, Rregullores Nr. __, datë __. __. __, arrihet në përfundimin se:

VI. Detyrat

Për rregullimin e shkeljeve të konstatuara sipërmarrësit/subjektit i lihen këto detyra:

VII. Vendimi për sanksione administrative

Grupi i inspektimit, bazuar në nenin _____ të ligjit nr.8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”, nenin _____ të Rregullores Nr. __, datë __. __. __, duke patur parasysh _____,

VENDOSI:

VII. Shënime:

_____.

Kundra këtij akti, sipas nenit _____ të Rregullores, mund të bëhet ankim administrativ pranë Këshillit Drejtues të AKEP.

NENSHKRUAJNE

Grupi i inspektimit:

Për sipërmarrësin/subjektin:
